



PERMBLEDHJE JOTEKNIKE TE AKTIVITETIT

“Avolzhim i statoreve te gjeneratoreve”

C.E.M.A. shpk

Subjekti: « CEMA » Sh.p.k

Hartoi :« Eko-Studio-Projekt » sh.p.k

Administratori: Shkelzen MADANI



Tirane, 2019



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT
2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI
3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS
4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE
5. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

✚ HYRJJE

Aktiviteti njezozor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Prodhim te profileve te aluminit”

✚ BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 266 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A, B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te*



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

hollesishme per shyrteimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».

- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ Profili i propozuesit

Subjekti: ”C.E.M.A” shpk, eshte regjistruar prane QKB me Nr. NIPT J82124001O me date 24.09.1998 me administrator Z. Gentian Shatku me vendndodhje ne TIRANE Njesia Bashkiake nr.5, rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, Godina nr.5, kati 9, zyra 91. Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje te re Mjedisore.

Qellimi i projektit

Qellimi i projektit eshte Avolzhim i statoreve te gjeneratoreve

Vendndodhja

Durres Maminas VLASHAJ Fshati "Vlashaj", Njesia Administrative Maminas, Bashkia Shijak, Objekti "Kapanone industriale 1-kat", ne pasurine e regjistruar ne ZRPP Durres ne nr.325/14, Zona Kadastrale 3796, Vol 1, Faqe 174

Projekte te tjera qe do ti vijne ne ndihme aktivitetit

Per zhvillimin e aktivitetit nuk do te kete projekte te tjera sepse sistemi rrugor ekziston. Eshte lidhur kontrata me rrjetin e shperndarjes se energjise elektrike. Ne rast mungese energjia elektrike do sigurohet permes nje gjeneratori.



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

Pershkrimi i procesit teknologjik

Shoqeria CEMA shpk me seli ne Tirane Rr. Ibrahim Rugova , Sky Tower, kati 9/1 dhe piken e prodhimit ne adresen Fshati Vlashaj, Maminas e ka filluar aktivitetin e saj te avolxhimit te statoreve te gjeneratore per te trete qe ne vitin 1998. Klienti kryesor i shoqerise eshte kompania italiane Elettromeccanica sas me seli ne Mestre (VE) te Italise nga e cila marim porosi per pune te klienteve te saj. Elettromaccanica dergon lenden e pare (pako hekuri, tel bakri, material izolues, kavo per lidhje) te klienteve te saj per tja rikthyer ne nje produkt gjysem te perfunduar (stator i avolxhuar dhe i lidhur).

Gama e produkteve tona eshte e larmishme dhe e fuqive te ndryshme. Aktiviteti i shoqerise konsiston ne perpunimin e lendeve te para si tel bakri, materiale izolues, kavo per lidhje, kapikorda, fije saldimi etj, per te krijuar dhe izoluar bobinen e bakrit duke bere thurjen e statorit, lidhur kavot dhe duke i dhene sagonaturen statorit, i cili futet ne furre dhe pas perfundimit te procesit teknologjik te pjekjes behet kontrolli dhe kolaudimi i tij per tu bere gati per tu nisur ne Itali. Shoqeria jone punon nen regjimin Perpunimit te Lendes se Pare te Porositesit i ashtu quajtur sistem FASON ne te cilin nuk shesim produktin, por vetem punen e bere prej saj.

Shoqeria CEMA shpk eshte e organizuar ne pese reparte:

Reparti i magazines (3 punetore)

Procedurat e punes ne repartin e Magazines

1-Ne momentin e ardhjes se materialeve duhet te peshohen te numerohen dhe te kontrollohen qe materialet nuk jane demtuar gjate transportit dhe te filloje me sistemimin e materialeve ne vendet e duhura. Ne rast demtimi te materialeve gjate trasportit duhet te njoftohet zyra per komunikimet. Me pas fillon me pergatitjen e materialeve qe nevojiten per mbulimin dhe lidhjen duke u bazuar tek distintat baze per cdo tipologji statori duke ndjekur programin ditore te prodhimit te vendosur me permasat , sasite dhe tipologjite e materialeve qe duhet te pergatise per prodhime te ndryshme.

Materialet qe perdoren gjate gjithe procesit te punes jane si me poshte :

1. Stator gjeneratori
2. Tel bakri per avolxhim
3. Materiale Izoluese(leter, tub, fije fashimi, ndares plastik, fashete)
4. Kavo per lidhje
5. Fije saldimiù
6. Izolator elektrik (rezine izoluese)+ boje e kuqe izoluese
7. Kapokorde



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

Reparti Bobinatriceve (6 punetore)

Procedurat e punes ne repartin Bobinatrice

Perpara se te nisi prodhimin e boninave duhet te verifikojte skemen perkatese per tipologjine e statorit per te cilin po thuren bobinat. Duhet te kontrolloje diametrin e fijeve, numrin e fijeve dhe te kontrolloje permasat e hapjes dhe tipologjine e sogomave qe do te vendosi ne bobinatrice. Ne varesi te tipit te bobinatrices duhen impostuar (vendosur) parametrat per statorin per te cilin do te behen bobinat.

Vetem pasi te kete bere keto verifikime dhe te kete marre aprovimin e pergjegjesit mund te rifilloje te bobinoje. Duhet gjithesesi te kontrolloje gjate prodhimit te bobinave qe fijet te mos kene probleme tek smalti izolus .

Reparti prodhimit qe eshte i ndare ne lidhje dhe avolxhim (25punetore lidhje 25avolxhim)

Procesi Avolxhimit

Perpara se te futen letrat ne kanal kontrollohet pako qe te jemi te sigurt qe nuk ka probleme me llamarinat (te spostuara ose ngritura). Gjate futjes se letrave ne kanal punetori duhet te sigurohet qe letrat te mos jene me te shkurtra apo me te gjata sec duhet. Para futjes te avolxhimit ndihmes kontrollojme qe bakri te mos kete probleme qe nga fabrikimi apo gervishtje te marra gjate punimit te bobinave, i vendosim ne kanale sipas skemes. Vendosim me rregull bobinat ne kanalet e duhura sipas skemes, gjate futjes se bobinave ne kanal keto te fundit mbrohen me leter. Gjate futjes se tegolinave duhet te sigurohemi qe keto te mos spostohen (anesore apo para-mbrapa)dhe qe te mos copetohet gjate futjes ne kave. Mbasi te kemi mbaruar pakon fijet e serise se bobinave vendosen ne meyre te tille qe te mos krijojne problem gjate procesit te lidhjes.

Procesi Lidhjes

Vendosim pakon sipas lartesis se testatave te pakos ne menyre qe te mos e deformatojme testaten apo ta gervishim. Mbasi te kemi vendosur me kujdes testaten vendosim separatoret apo mezaluna me kujdes ne menyre qe te mos marrim fije nga faza te tjera bobinimi. Pas vendosjes se izoluesve fillon fashimi i anes se kunder te kavove . Gjate kesaj faze duhet bere kujdes qe pjesa metalike e instrumentit te fashimit te mos preki fijet e bobinave duke rrezikuar qe te gervishi fijet.Punetori duhet te vendosi izoluesit dhe tek ana e kavove sic beri dhe me pare. Bejme sipas skemes dhe pastaj sistemojme fijet e serise te boninave dhe vazhdohet me futjen e tubave izolues. Me pas bashkojme kavot per lidhje me fijen e serise se bakrit nepermjet fijes se saldimit. Me pas behet sistemimi i kavove duke i mberthyer me fashete qe te mos levizin.Pas kesaj fillojme me fashimin e testates nga ana e kavove. Pas fashimit fillojme te godasim testaten ne anen e kavove ne menyre qe te mos demtojme



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

materialet izoluese qe kemi futur ne pako. Para se te heqim pakon e mbaruar nga tavolina e punes e vendosim horizontalisht dhe kontrollojme diametrin dhe lartesine e testatave. Ne fund rikontrollojme izoluesit.

Reparti Kolaudimit (2 punetore)

Procedurat e punes ne repartin Kolaudo

Per cdo stator perpara se te vendoset ne paisjen e kolaudimit duhet bere nje kontroll viziv te testatave dhe te pakos per te pare nese ka demtime apo shenja te vecanta (anomali gjate punimit). Kontrollohen permasat e testatave per te pare nese jane sipas specifikave te klienti (me Dimo, ose me matje me meter ose kaliber) Nese nga kontrolli i larte permendur dallohen probleme punetori i kolaudos duhet te njoftoje pergjegjesin, Pas kesaj vendosen kavot tek morsetiera e makinerise se kolaudos dhe behet testi me anet te programit te posacem. Nese testi del OK pakoja vendoset ne bankalet e posacme, ne rast te kunder vlejme procedurat qe pershkruam me siper.

Reparti Furre

Pasi pakot kane kaluar fazen e kolaudimit kalohen ne repartin e furre ku keto pako vendosen ne vasken me rezine izolues, ku qendrojme per rreth 15 min. Pas ketij procesi vendosen ne zgarrat perkatese dhe futen ne furre. Pas daljes nga furra pakot kontrollohen nese kane mbetje te rezines izoluese, nese po pastrohen me rrote abrazive. Pas ketij procesi statori lyhet me boje te kuqe izoluese. Pasi mbarojme te gjithe procesin e siper permendur statoret paketohen neper bankalet perkatese dhe jane gati per esporti.

Administrata do te perbehet nga :

1. Pergjegjes Cilesie (2 persona)

Pergjegjesi i cilesise ka per detyre te monitoroje punetoret gjate procesit te punimit te pakove duke kontrolluar qe te mos kete punime jo cilesore dhe te kontrolloje produktin final ne menyre qe cilesia e mallit te jete ne nivelet e kerkuara.

2. Asistente Zyre (1person)

Asistenti I zyres do te kujdeset per funksionimin e zyres duke perfshire receptionin (pritja e pare ne ambientet e CEMA shpk) mbajtjen e korespondences, te kujdeset per protokollin dhe te siguroje bazen materiale qe nevoiten per zyren.

Kapanonet kane nje siperfaqe prej 1677 m² ku do te punojne reth 65punonjes.

Ndricimi ne kapanonet tona eshte ne dy forma ndricim natyral qe hyn ne kapanon nepermjet dritareve dhe ai artificial nga neonet e vendosur ne te gjithe hapsiren e kapanonit. Ajrimi i



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

ketyre hapsirave kryhet ne menyre natyrale nepernjete dritareve te vendosura ne te gjithete siperfaqen e kapanoneve .

Zhurma, ndotje,dhe substanca te rrezikshme nuk ka.

Ambientet kane te perfshire dhomat e zhveshjes(te pajisura me dollape personale) dhe tualetet te ndare sipas gjinise se punonjesve, si dhe ambientet e menses e cila eshte e perbashket.

PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI



Durrësi është qyteti i dytë më i madh në Shqipëri. Qyteti ka mbi 200,000 banorë dhe njëkohësisht është qendra e prefekturës dhe qarkut të Durrësit. Është një nga qytetet më të lashtë dhe më të rëndësishëm ekonomikë të Shqipërisë. Durrësi është i vendosur në bregdetin qëndror shqiptar, rreth 33 km (21 mi), në perëndim të kryeqytetit Tiranë. Ai ndodhet në një nga pikat më të ngushta të Detit Adriatik, përballë porteve italiane të Barit (300 km/186 mi larg) dhe Brindisit (200 km/124 mi larg). Qyteti i Durrësit është i populluar nga rreth 202.000 banorë (me të dhënat e vitit 2009). Në qytetin e Durrësit ndodhet universiteti më i ri publik në Shqipëri i quajtur Aleksandër Moisiu. Durrësi mbahet mend edhe si kryeqyteti i shtetit shqiptar nga 7 marsi 1914 deri më 11 shkurt 1920. Durrësi u bë kryeqytet i Mbretërisë së Shqipërisë nga Princ Vidi kur ai zbarkoi më 7 mars 1914 e deri në vendimin e Kongresit të Lushnjës të datës 11 shkurt 1920 për shpalljen e Tiranës si kryeqytetin e ri të shtetit shqiptar.

Klima

Klima në Durrës është e ulët 5 °C në janar dhe e lartë 28 °C në korrik dhe gusht. qershori, korriku dhe gushti janë muajt, më të nxehtë dhe më të thatë.

Durrës - Temperatura dhe reshjet mesatare mujore

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrikk	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Temp. Maks. (°C)	11	12	15	18	23	28	30	30	26	22	17	12	Ø 20,3
Temp. Mini. (°C)	4	5	8	11	15	19	21	21	17	14	10	6	Ø 12,6
Reshje (mm)	91	103	99	83	63	50	31	43	118	80	146	140	Σ 1.047





Flora dhe Fauna

Nga pikëpamja floristike, rrethi i Durrësit bën pjesë në zonën e shkurreve mesdhetare, te përfaqësuar nga dafina, shqopa dhe nga shkurret te tjera në formën e kacubeve te veçanta.

Pranë bregut te detit shtrihet një brez gjelbërimi me pisha te zhvilluara mire. Zona karakterizohet nga prania e një bimësie natyrore me moshe 80 vjeçare që dominohet kryesisht nga pisha e bute dhe e egër me moshe 19-24 vjeçare.

Gjate bregdetit gjendet një baze pyjore natyre prej dushku dhe shelgu me moshe 60-80 vjeçare, i alternuar me pyll artificial prej pishash e plepash me moshe 20 vjeçare. Zona e shpallur park kombëtar “Parku Kombëtar i Rrushbullit” në te cilin ndodhen 380 ha me pyje mjaft tërheqëse, nga te cilat 50 ha me pyje te larta dhe 330 ha me pyje te ulëta. Një problemet shqetësuese është se ky pyll është dëmtuar në një mase te konsiderueshme nga prerja pa kriter nga vete banoret e zonës përreth për qëllime personale.

Konditat klimatike te zonës lejojnë te zhvillohet një bimësi e shumëllojshme që nga pishat, plepi, frasheri i zi, morina, palma dhe dafina, deri në bimët e tjera dekorative si: frasheri gjethengushtë, vërria, eukalpti, shelgu lotues, etj.

Kur temperatura mesatar është mbi 10 °C periudha e vegjetacionit fillon në ditët e para te marsit dhe përfundon në ditët e para te dhjetorit. Te ruajtura në forme natyrore shumica e drurëve te lartpërmendur gjenden në territorin e ish “Bllokut” që përben një zone me karakterin e një parku natyror te këndshëm.

Në zonat me te larta te rrethit (p. sh. zona e Ishmit) rriten shkurre që i rrezojnë gjethet e tyre gjate atines se dimrit si : shkuza, murrizi, driza, etj. Në Xhafzotaj, Sukth, Gjipale, Spital etj, rriten edhe bime te ulëta si: mullaga, hithra, lulekuqa, tatulla, kopra e egër, ndërsa gjethe delli, lulebasami, hithra, grami, rrodhja, netulla, bar pate rriten kryesisht në zonën e Shijakut, Maminasit, Katundi te Ri dhe Ishmit.

Përveç bimësisë pyjore që zë vend te rëndësishëm në bimësinë e rrethit, po kaq rëndësi kane edhe kulturat buqesore te përfaqësuar nga : gruri, misri, fasulja, ulliri, lule dielli, te cilat përhapjen me te madhe e kane në zonën e Shijakut, Maminasit, Spitalles, Sukthi. Pothuajse në te gjithë rrethin kultivohen perime si: speci, domatja, kastravec, bizelja, etj. dhe agrumet (portokalli, limoni) te cilat prodhohen me shume pergjate bregdetit.



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

2. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasoje të veprimtarisë bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e funksionimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjeneruara, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe social-ekonomik.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqen hapat e mëposhtme:

- Njohja me teknologjinë që do të përdoret
- Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes ku do zhvillohet aktiviteti

Duke analizuar natyrën e të gjithë proceseve dhe format e shfaqjes së tyre, direkte ose indirekte, përcaktohet qartë lloji i ndikimeve. Të gjitha ndikimet mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim të proceseve të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

Shkarkime në ujë

Ujërat higjieno-sanitar të krijuara nga stafi i subjektit do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve të zonës. Gjithashtu ujërat që do të përdoren për pastrimin e territorit nuk do të jenë me karakter ndotes dhe të demshëm për mjedisin. Operatori në momentin që do të fillojë operimin do të kryejë një monitorim paraprak e më pas një monitorim të vazhdueshëm në një hark kohor çdo 6 muaj për të patur nën kontroll situatën.

Emetimet në ajër

Emetimet që do të vijne nga procesi teknologjik do të jenë minimale dhe jo të demshme për shëndetin e punonjësve dhe zonës përreth. Gjithashtu emetimet do të vijne edhe nga mjetet e transportit. Këto emetime do të jenë minimale pasi mjetet e transportit do të jenë të kolauduara konform legjislacionit në fuqi.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurma dhe vibrime do të jenë në nivele minimale, sepse teknologjia që do të instalohet është e një standarti të lartë Europian dhe bashkohore. Në rastin e proceseve që mund të emetojnë zhurma punonjësit do të përdorin të gjitha mjetet mbrojtëse për të mos pasur



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

problem ne sistemin e degjimit. Gjithsesi operatori do kryeje nje monitorim paraprak dhe me pas te vazhdueshem.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje te ngurta qe do te prodhohen nga konsumi i perditshem ne kete objekt do te jene mbetjet e ngurta si plastike, shishe qelqi, materiale letre etj. Keto mbetje duhet te menaxhohen ne bashkepunim me NJ.Q.V. Theksojme se nuk do te kemi kemi gjenerime te mbetjeve te rrezikshme.

Ndikimet ne flore dhe ne faune

Zona ne te cilen do te zhvillohet aktivitetit është një zonë në të cilën nuk takohen elemente te flores apo faunes se rralle. Gjithashtu nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk kemi ndikime negative as ne flore as ne faune. Perreth kësaj zone, mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte te ndryshme. Jashtë konturit të impjantit, zona nuk ndryshon.

Flora bëhet gjithnjë e më e larmishmë duke u larguar nga objekti. Kjo ka të bëjë me bimet e arave dhe pemët të cilat rriten në fushat rreth impjantit. Si zonë kultivon drithra, lakrën, bamjen, domaten e shumë perime të tjera. Në pemtari mund të përmëdim portokallen, ullinjt, kumbullen, rrushin etj.

Më të pranishem janë shpendët shtëpiake dhe kafshët shtëpiake, janë shumë të përhapur zogjtë e llojeve të ndryshme që rriten në zonën e Shijakut, si harabelat, cirlet, mëllenjat, gushkuqi, dallëndyshet etj, insekte e zvarranikë të llojeve të ndryshme.

Ndikimet ne ekonomi

Persa i perket ndikimeve ekonomike ky projekt do te sjell efekte direkte ne punesimin e popullsise se zones, pra do te rris tregun e punes si rrjedhim do te rritet edhe mireqenia e nivelit te jeteses te popullsise se zones.



3. MASAT PER ELEMENIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

- Mbetjet e ngurta urbane që do të prodhohen ne objekt të depozitohen në vendet e përcaktuara nga NJ.Q.V, madje operatori do te vendos koshat qe keto mbetje ti ndaje nga karakteri i tyre.
- Do te sistemohet dhe do te rehabilitohet siperfaqja pas ndertimit dhe gjate operimit te aktivitetit.
- Automjetet e transportit te qarkullojne me shpejtesi te ulet te menyre qe te mos krijohen vibrime.
- Ne pjesen e mbetur te siperfaqes se lire mbas ndertimit operatori duhet te mbjelle sa me shume peme per te krijuar nje pamje vizuale te bukur por edhe per te ulur ndikim ne mjedis edhe pse nga te gjitha gjykamit e bera ato jane ne nivele te ulta dhe totalisht te pranueshme.
- Operatori duhet dhe do te jete I kujdeshem ne mirefunksionimin e gropes dekantuese qe do te ndertoje per llogari te aktivitetit.
- Duhet dhe do te kryeje monitorimin e vazhdueshem lidhur me shkarkime ne uje, ajer, toke per te qene gjithmon i informuar.
- Masat per mbrojtjen kunder zjarrit te cilat jane shume te rendesishme duke qene se eshte zone e mbrojtur ato jane parashikuar ne projekt dhe jane si me poshte:
 - Pozicionimi i shenjave ne vende te dukshme dhe vendosja e instruksioneve per veprimet qe duhet te kryeje personeli nhe rast zjarri.
 - Pozicionimi i shenjave qe paraqesin pozicionet e sharresve te zjarrit,rruget e largimit dhe daljet e emergjnces
 - Largimin e materialeve te ndezshme nga ambjentet e godines dhe vendosjen e tyre ne vende te sigurta per parandalimin e transmetimit te zjarrit
 - Mbajtje e lire e rrugeve te largimit
 - Mirembajtje dhe kontroll i vazhdueshem i instalimeve elektrike ne perputhje me rregullat perkatese per instalime te tilla.
 - Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe destinacionin e saj jane perdorur substanca shuarese si me poshte:
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidtrante te jashtem
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidtrante te brendshem
 - Shuares portable ne te gjitha pozicionet te cilat parashikohen ne project.



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

➤ Detyrat e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:

- Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Do te punesohen punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziket ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Punonjesit do te pajisjen me mjete mbrojtese si dhe unifromat perkatese,
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.

➤ Detyrat e punonjesve:

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difekt dhe nuk eshte ne gjendje ta eliminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni pergjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.

4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUZIONE

- Zhvillimi i ketij nuk shoqerohet me lindjen e ndonje impakti negative ne mjedis. Jane marre te gjitha masat si nga ana teknologjike ashtu edhe nga ana administrative per te evidentuar ndonje impact te mundshem.
- Niveli i zhurmave në impiant eshte ne parametra normal dhe ne nivele të pranueshme. Nuk eshte shqetesues per banoret e zones edhe pse ata jane ne nje largesi te konsiderueshme.
- Gjatë procesit të prodhimit nuk do te kete shkarkime me karaktere ndotes as ne ajer as ne uje dhe as ne toke. Mbetjet do te evadohen ashtu sic e parashikon legjislacioni aktual ne fuqi.
- Gjatë procesit të ngarkim – shkarkimit do meren masat qe mjetet te ruajne shpejtesine e lejuar per te evituar ngritjen e pluhurave, gjithashtu do te laget siperfaqja pas largimit te mjeteve. Eshte e rendesishme te theksohet fakti se keto makineri do te kryejne kete sherbim ne periudha te caktuara te vitit.
- Per nje pune sa me optimale duhet te zbatohen rregullat e sigurimit teknik ne pune dhe te mbahet nje kujdes shume i vecante lidhur me kushtet higjeno sanitare.



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

REKOMANDIME

- Te kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen kanalet kulluese ne territor.
- Te behet gjelberimi i mjedisit duke shtuar siperfaqete gjelberta.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet e ndryshme qe mund te lindin nga zhvillimi i ketij aktiviteti.
- Te largohen te gjitha mbetjet ngurta qe krijohen si rezultat i punes dhe aktivitetit njerezor ne vendet e percaktuara nga pushteti lokal.
- Te mbahet kontakt i vazhdueshem me ARM e rrethit dhe te dergohet informacion periodik per shkarkimet ne ajer, uje dhe toke.